

V E N D I M
Nr.233, datë 19.5.1993

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.345, DATË
10.8.1992 "PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE"**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 "Për shpërblimin e punës së punonjësve", në pikën 7 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në bashkësitë ekonomike, anëtarët e këshillave drejtues që nuk janë në marrëdhënie pune me bashkësinë, u jepet një shpërblim 3-mujor i barabartë me deri 80 për qind të pagës bazë mujore të drejtorit ekzekutiv. Anëtarët e këshillit ekzekutiv dhe drejtori ekzekutiv kanë të drejtë të marrin shpërblim suplementar sipas paragrafit të tretë të kësaj pike".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet financiare që rrjedhin prej tij shtrihen nga data e emërimit të këshillave drejtues dhe ekzekutivë të bashkësive.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi